



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT  
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 154 / Prot.  
1

Tiranë, më 31.01 . 2019

**VENDIM**

**“I Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”**

**Nr. 5, datë 31.01.2019**

Në zbatim të neneve 8 dhe 39 të rregullores “ Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit të Gjykatës Kushtetuese ”, të nenit 57 të rregullores “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit” dhe të nenit 10 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”, Mbledhja e Gjyqtarëve,

**VENDOSI:**

1. Të bëhen ndryshime në nenin 18, pika 1, në nenin 24, pika 1, pika 3 dhe pika 4. pika 5; në nenin 25, pika 1 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit të Gjykatës Kushtetuese”.
2. Të bëhen ndryshime në nenin 38 pika 3 dhe 4 të rregullores “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”
3. Të bëhen ndryshime në nenin 3 pika 4 të rregullores së Kolegjit të Posaçëm të Apelitit “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**



**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E PERSONELIT DHE ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8 të rregullores “ Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese” dhe të nenit 57 të rregullores “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, Mbledhja e Gjyqtarëve,

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në nenin 38 bëhen ndryshimet si më poshtë:

Pika 3, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

Sekretari Gjyqësor brenda 24 orëve përpilon aktin e konstatimit duke pasqyruar në mënyrë të hollësishme të metat e identifikuara nga verifikimi i dosjes. Drejtori i Menaxhimit të Çështjeve i kërkon institucionit dërgues KPK-së plotësimin/korrigjimin e të metave, brenda 5 ditësh pune nga momenti i njoftimit.

Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

4. Në rast se të metat e identifikuara nuk plotësohen/korrigjohen brenda afatit 5-ditor, përgatitet shkresa për kthimin e gjithë dokumentacionit të marrë në dorëzim sipas nenit 37, pika 3 e kësaj rregulloreje institucionit dërgues (KPK-së). Akti i konstatimit, pas miratimit nga Drejtori i Menaxhimit të Çështjeve, i bashkëlidhet shkresës administrative për kthimin e dokumentacionit, e cila i përcillet për nënshkrim Kryetarit.